



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË PARAQITJEN E REZULTATEVE PËR SHQIPËRINË TË RAPORTIT “MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE”**

*8 tetor 2019*

Të nderuara ministre, të nderuar partnerë të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian!

Kur lexova anketën, e vetmja gjë që nuk më pëlqeu ishte titulli: “Mirëqenia dhe siguria e grave”. E kundërta është e vërtetë.

Ju faleminderit që më ftuat të jem pjesëmarrës në prezantimin e këtij raporti të rëndësishëm.

Dhuna ndaj grave shpesh është e fshehtë - e mbrojtur nga sytë jo vetëm të publikut, por edhe nga sytë e miqve dhe anëtarëve më të ngushtë të familjes së viktimës. Padukshmëria e viktimave fsheh përmasën e vërtetë të problemit.

Ky raport i rëndësishëm i OSBE-së hedh dritë mbi këtë çështje. Ai ndriçon shkallën e vërtetë të dhunës që pësojnë gratë. Pothuajse 9 në 10 gra e quajnë dhunën ndaj grave normale në Shqipëri – 9 në 10. Më shumë se gjysma e viktimave të ngacmimit seksual heshtin – më shumë se gjysma. Ndërsa 97% e viktimave të dhunës intime brenda shtëpisë kurrë nuk e raportojnë atë në polici – 97%.

Çdo rast i dhunës ndaj grave, qoftë ajo dhunë fizike apo dhunë psikologjike, është një shkelje e të drejtave të njeriut, pasi përbën shkelje të dinjitetit themelor njerëzor, të së drejtës themelore të njeriut për siguri fizike ose, në raste ekstreme, shkeljen e së drejtës për jetën.

Pothuajse gjysma e të gjitha të anketuarave raportojnë se e shohin dhunën ndaj grave si çështje private – merreni me mend. Të drejtat e njeriut nuk janë kurrë çështje private, kurrë. Ato gjithmonë janë çështje publike dhe, veçanërisht në këtë rast, çështje që përputhet plotësisht me misionin e OSBE-së.

Do të dëshiroja t'ju përgëzoja për interesin dhe përkushtimin tuaj, për kontributin tuaj, në këtë përpjekje të përbashkët për të kuptuar më mirë dhunën me bazë gjinore. Shpresoj që sondazhi i udhëhequr nga OSBE-ja, që paraqitet sot, të informojë dhe përmirësojë punën tuaj të rëndësishme për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore.

Hapi i parë për zgjidhjen e çdo problemi është njohja e tij. Ky është sondazhi i parë që siguron prova të fortë, gjithëpërfshirëse të dhunës ndaj grave dhe vajzave, që janë të krahasueshme në rajon. Hulumtimi është i bazuar në metodologjinë e përdorur nga Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), duke lejuar kështu krahasimin e të dhënave për fenomenin në mbarë kontinentin.

Të dhënat tregojnë qartë nevojën për veprim. Normat kulturore dhe qëndrimet mbështesin bindjen e grave ndaj burrave dhe dhuna seksuale intime në marrëdhëniet me partnerin pranohet gjerësisht. Këto besime janë të ndërlidhura ngushtë. Ato kontribuojnë në një mjedis ku dhuna ndaj grave është e shfrenuar. Burrat dhe gratë duhet të marrin pjesë në ndryshimin e

këtyre normave kulturore. Në të njëjtën kohë, gratë duhet të fuqizohen të raportojnë dhunën. Raportet e tyre duhet të merren seriozisht nga policia, prokurorët dhe gjykatësit, dhe autorët duhet të nxirren para drejtësisë.

Mbetem me shpresë se ky raport do të shënojë fillimin e një përpjekje të bashkërenduar kulturore, politike dhe juridike të shoqërisë shqiptare për të trajtuar çështjen e dhunës me bazë gjinore. Jam i bindur kur them se OSBE-ja është e vendosur të vijojë të punojë në këtë fushë, bashkë me partnertët tanë shqiptarë, dhe është e gatshme të ofrojë mbështetje dhe ekspertizë të mëtejshme.

Faleminderit për vëmendjen!

**Fund**